



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:042088

Datë: 18.11.2022

Numri i dokumentit: 03664768

**P.nr. 200/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGGJITHSHËM**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.SH. nga fsh.K., K. K për shkak të veprës penale, *“Lëndim i lehtë trupor”*, e nga neni 185 par.3 nënpar.1 dhe neni 1.4 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II nr.308/21 të datës 03.03.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të dt. **08.11.2022**, në prezencë të Prokurori i shtetit Lumturije Hoxha, i pandehuri B.SH., të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.18.11.2022, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari,**

**B.SH.**, i biri i Xh.dhe nënës A. e vajzërisë Q., i lindur më .... në P., me vendbanim në fshati i K., K- K., i pa punë, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. ...., me numër të tel. .../...-..., nacionaliteti egjiptian, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri.**

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Me datë 03.01.2021, rreth orës 17:30, në fsh. L. K-P., brenda marrëdhënies familjare, me dashje, i shkakton lëndime të lehta trupore viktimës së ndjeshme K. S. të cilën e ka bashkëshorte, në atë mënyrë që, natën kritike pas një fjalosje që kishin në mes vete, i pandehuri e tërheq me forcë të dëmtuarën që ta dërgoj tek familja e saj në fsh. L., dhe gjatë rrugës në automjet e godet me grushta në kokë dhe në qafë, ku si pasoj e këtyre goditjeve e dëmtuara pëson dëmtime të lehta trupore,

Me çka ka kryer veprë penale *“Lëndime të lehta trupore”* nga neni 185 par. 3 nënpar. 1 dhe neni 1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17 par.1, 46 par.1 pika 1.1, 47.48, 49, 50, 51, 52, neni 185 par. 3 nënpar. 1 dhe neni 1.4 të KPRK-së, si dhe nenin 365, 366, 453, 463 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

## D Ë N I M I N M E K U S H T

- I. Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
- II. Dënimi me kusht nga dispozitivi I i këtij aktgjykimi do të revokohet nëse i akuzuari kryen veprën tjetër penale.
- III. I akuzuari lirohet nga paguaja e shpenzimeve të procedurës penale në kuptim të nenit 453 par. 4 të KPRK-së, pasi që është marrëse e ndihmës sociale sipas kartelës të paraqitur.
- IV. E dëmtuara K. S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civilo-juridik.

### A r s v e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II nr.308/21 të datës 03.03.2021, kundër të akuzuarit B.SH. nga fsh. K., K. . për shkak të veprës penale, “Lëndim i lehtë trupor”, e nga neni 185 par.3 nënpar.1 dhe neni 1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 08.11.2022 në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxhaj dhe i akuzuari B.SH..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit nën shenjen PP/II. Nr.308/21 të datës 03.03.2021, në seancën e shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurores së Shtetit, të akuzuarit B.SH., gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e **pranon fajësinë**, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq për veprimin e bërë, i premtion gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla.

Prokurorja e shtetit, në lidhje me pranimin e fajësisë, nga ana e të akuzuarit B.SH. ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë, meqenëse ky pranim i fajësisë i plotëson kushtet ligjore dhe po ashtu ka mbështetjen në shkesat të lëndës dhe i propozoj gjykatës që ketë pranim të fajësisë ta aprovon.*

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë, pasi që i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit dhe pranimi i fajit mbështetet edhe në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështetet aktakuza siç janë: *raportin e policit*

*C. K. me numër ...-...-00.. i dt.03.01.2021, raporti i policit G. N. i dt.03.01.2021, deklarata e të dëmtuarës K. S. e dhënë në polici me dt. 03.01.2021, deklarata e të pandehurit B.SH. e dhënë në polici me dt. 03.01.2021, raporti mjekësor në emër të dëmtuarës K. S. i lëshuar nga spitali i përgjithshëm në Pejë, raporti mjekësor në emër B.SH. i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Peje, akt ekspertiza mjeko-ligjore e dt. 13.02.2021, si dhe të shikohet foto dokumentacioni me shkresat e tjera të lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga e të akuzuarit.*

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe duke u ndërlidhur me atë se ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 248 par 1, të KPPRK-së, atëherë, ne këtë çështje penale, nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarës se e pranon fajësinë, mendimit të prokurorit të shtetit ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

*Prokurorja e shtetit lidhur me rrethanat lehtësuese dhe renduese ja lë në vlerësim gjykatës.*

*I akuzuari B.SH. lidhur me rrethanat lehtësuese dhe renduese ka deklaruar se me vjen keq që ka ndodhur ky rast, unë jam i penduar, i premtoj gjykatës që ne të ardhmen nuk do ta përsëris veprimet e tilla, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, unë marr ndihma sociale dhe jam i gjendjes së dobët ekonomike, dhe i propozoj gjykatës që të këtë parsyshë këto rrethana dhe mundësisht të me shqiptoi një dënim sa me të butë.*

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i akuzuari ka ekzistuar dashja që veprat penale ti kryej në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i akuzuari ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që e njëjti është penalisht përgjegjëse.

Gjyqtari i vetëm gjykues në aplikim te nenit 69 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara e të përmendura nga ana e palëve në procedure gjatë seancës të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i akuzuari ka pranuar fajësinë, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, i njëjti ka kërkuar falje për veprimet e tij, së është penduar thellë, jetojnë së bashku i kanë dy fëmijë dhe ka deklaruar se nuk do të përsëris veprime të tilla në të ardhmen, ndërsa si rrethana rënduese gjykata në rastin konkret nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Për më shumë sipas bindje se gjykatës çfarëdo dënim tjetër për rastin konkret do ishte në shpërprthje me rrethanat e rastit jo drejtë risocializimit por ishin drejt de risocializimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me kusht u mor konform dispozitave ligjore të nenit 48 dhe neni 184 par. 1 të KRPK-së.

Vendimin mbi zëvendësimin e dënimit me kusht, në dënim burgimi në rast se i akuzuari brenda periudhës së verifikimit kryen vepër tjetër penale, u mor në përputhje me nenin 50 par. 1 dhe 2, të KRPK-së.

I akuzuari lirohet nga paguarja e shpenzimeve të procedurës penale në kuptim të nenit 453 par. 4, të KRPK-së, pasi që është marrësit e ndihmës sociale sipas kartelës të paraqitur e cila është e bashkangjitura në shkrësat e lëndës.

Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore-juridike u mor konform dispozitës së nenit 463 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,  
P.nr.200/21, dt. 18 .11.2022**

**Bashkëpunëtore profesionale,**

\_\_\_\_\_  
Teuta Spahija

**GJYQTARI,**

\_\_\_\_\_  
Dr. Sc. Murat Hulaj

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.